



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

FORMULAR PROPOZIMI

**Paraqitja e Asetit të Trashëgimisë Kulturore për Përcaktim në Mbrojtje të Përhershme
Trashëgimi Arkeologjike, Arkitekturale, Peizazh kulturor**

EMËRTIMI ZYRTAR I ASETIT TË PROPOZUAR

Kalaja e Prizrenit



Pamje e vitit 2016



Pamja e kalasë nga ajri dhe pozita gjeostrategjike e kalasë mbi zonën përreth.

Datimi/et (Relativ/e)

Periudha/t historike : Bronzi i vone, antikitet i vonë, mesjetë, osmane deri ne vitin 1913/1914

Adresa: Prizren, Komuna e Prizrenit

Lloji i asetit të propozuar : Trashëgimi Arkeologjike- Rezervat/ Arkitekture

Nënkategoria : Lokalitet arkeologjik

Numri unik: 1967

Numri i regjistrit në KKTK

Statusi i mbrojtjes ligjore të mëhershme/referenca e dokumentit/aktit nëse ka

Vendimi Nr. 1585/48 - 2011/ 2015

ARSYESHMËRIA RRETH VENDOSJES SË ASETIT NË MBROJTJE TË PËRHERSHME

Kalaja e Prizrenit është përfaqësuesi më i veçantë i një vendbanimi prehistorik, antik, mesjetar dhe po ashtu gjatë periudhës osmane është shfrytëzuar më shumë si garnizon ushtarak. Nga gërmimet arkeologjike u konstatua që kalaja ruan në vete depozitime të periudhës së bronzit të vonë, antikitetit të vonë dhe për të vazhduar pastaj gjatë gjithë periudhës mesjetare dhe osmane. Kalaja është e rrethuar me mure të larta rrethuese, kulla, porta si dhe është e ndarë në katër pjesë.

Brenda kalasë ruhen gjurmë të shumë objekteve arkitekturore, e sidomos të periudhës osmane. Pozita e veçantë e kalasë, pasuria kulturore, peizazhi natyror, e bëjnë atë shumë atraktive për turizëm kulturor.

Kriteret e përzgjedhjes sipas së cilave është propozuar aseti

Specifikimi/përshkrimi i kriterëve sipas Nenit 4, Rreg.Nr.5.2008/MKRS

Vlerat arkeologjike: Depozitimet kulturore të kalasë kapin një gamë të gjerë kohore duke filluar nga periudha e bronzit të vonë e për të vazhduar deri në luftërat ballkanike 1912/ 1913 kur përfundimisht braktiset .

Vlerat arkitekturore: Ruajtja e shumë strukturave arkitekturore të shumë periudhave kohore paraqesin një vlerë të veçantë për studimin e historisë të arkitekturës në regjion dhe formën e ndërtimit të vendbanimeve të fortifikuara gjatë shekujve. Ruajtja e shumë strukturave brenda kalasë si kazamatet, portat, depoja e ujit, magazinat, kullat, xhamia etj. na krijojnë mundësi për krijimin e një pasqyre me të qartë mbi arkitekturën mesjetare dhe të periudhës osmane.

Vlerat shkencore: Depozitimet e shumta të shtresave kulturore dhe materiali i pasur arkeologjik, ruajtja e shumë gjurmëve arkitekturore, paraqesin një vlerë të veçantë për studimin e proceseve kronologjiko- kulturore dhe popullsisë iliro -dardane dhe shqiptarëve të hershëm gjatë periudhës mesjetare.

Vlerat historike: Të dhënat e shumta arkeologjike, arkitekturore, fotot e vjetra etj. na ndihmojnë të ndërtojmë një tablo me të qartë të zhvillimeve të proceseve historike.

Vlerat e peizazhit kulturor: E vendosur në një shkëmb masiv mbi qytetin e Prizrenit në njërin anë dhe në kontroll të rrugës përgjatë Lumbardhit të Prizrenit e bën kalanë një kurorë të veçantë të qytetit të Prizrenit dhe më gjerë.

Propozuesi:

Institucioni **Instituti Arkeologjik i Kosovës**

Emri/ Mbiemri: **Enver Rexha** Nënshkrimi

Adresa dhe kontakt informacione: **Rr. Nazim Gafurri, p.n. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës**

Data : .../.../.....

***Bashkangjitur:*Lista e të dhënave dhe dokumentacioni**

1. Të dhënat mbi lokacionin e asetit
2. Të dhënat mbi asetin
3. Propozim deklarata e rëndësisë
4. Gjendja e asetit
5. Mbrojtja dhe menaxhimi i asetit/Masat juridike dhe teknike
6. Monitorimi
7. Dokumentacioni përcjellës

Pranimi

Nr. protokolit .../.../... Dt.../.../.....

Zyrtari përgjegjës

Emri Nënshkrimi

1. LOKACIONI I ASETIT

Komuna, Qyteti/Fshati/Adresa

Prizren, Komuna e Prizrenit

Të dhëna themelore të Komunës, fshatit apo qytetit

Qyteti i Prizrenit gjendet gati ne piken me jugore te Rrafshit te Dugagjinit ne Republiken e KOsoves.

Shtojcë 1: A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse

Koordinatat gjeografike - Latituda/Longituda (KosovaNewRef I)

Përshkrimi tekstual i situacionit të asetit të propozuar, me linjëzim të perimetrit territorial dhe zonës rrethuese për mbrojtje /buffer zone

Kalaja e Prizrenit gjendet në anën jug- lindore të Prizrenit me një sipërfaqe rreth 1.5 ha brenda murit aktual të kalasë.

Perimetri i asetit të propozuar: 1.5 ha

Zona rrethuese për mbrojtje/Buffer zone: 2.5 ha

Sipërfaqja totale: 4 ha

Hartat dhe planet e situacionit

Shtojcë 2:

- Planet e situacionit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese $P=1:500$ dhe $1:200$ (nëse është e aplikueshme).
- Planet kadastrale të asetit të propozuar për mbrojtje.
- Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës së mbrojtur rreth tij (buffer zone), gjeoreferencat në min. tri pika, koordinatat, shënimi i përpjesës, orientimi, projekcioni, emri i pronarit dhe data.
- Me qëllim të përfshirjes së asetit në GIS, informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.

2. PËRSHKRIMI I ASETIT

Përshkrimi i elementeve përbërëse të asetit, përfshirë ndërtesën/strukturën apo ndërtesat/strukturat, stratigrafinë dhe elementet tjera ndërlidhëse me asetin

- Përshkrimi i asetit të propozuar nga momenti i propozimit, duke specifikuar përmbajtjen e të gjitha elementeve dhe karakteristikat domethënëse të tyre ndërlidhur me atributet e trashëgimisë kulturore.
- Në rastin e trashëgimisë arkitekturore (monument, ansambël/tërësi dhe fushë e konzervimit arkitektural) dhe të trashëgimisë arkeologjike (monument, ansambël, lokalitet apo rezervat) të bëhet përshkrimi i të gjitha elementeve ndërlidhëse të asetit në kuptimin e veçorive të trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër përfshihet përshkrimi i ndërtesës, strukturës ose ndërtesave/strukturave, planimetritë, sistemi i ndërtimit, stili arkitekturor, proporcionet, ritmi, enterieri, materialet, datimi dhe aspektet tjera ndërlidhëse të lokacionit të asetit, siç janë: terreni, oborri, mobiliet, pikturat, ikonat, mbishkrimet epigrafike, mjedisi rreth tij, etj.
- Në rastet e qyteteve ose të një qendre historike, të bëhet përshkrimi i ndërtesave historike kryesore të karakterit publik me përshkrimin e mjedisit rrethues.
- Ndërlidhur me lokalitetet apo rezervatet arkeologjike dhe artin shkëmbor, të bëhet përshkrimi i peizazhit mjedisor. Ndërsa, peizazhi kulturor të përshkruhet njejtë si në rastet e lartëshënuara, duke përqendruar vëmendjen në specifikat e ndërveprimit historik ndërmjet njeriut dhe natyrës.

Mbi bazën e gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në vitet 1969, 2004 dhe 2009- 2016 është krijuar një tablo më e plotë mbi shumë aspekte shkencore. Përveç murit rrethues dhe të katër ndarjeve që ka kalaje janë evidentuar edhe shumë porta, kulla, kazamate, depoja e barutit, magazina, rezervuar uji, gypi i furnizimit - ujësjellësi, xhamia etj. (Shih planimetrin). Në stratigrafinë vertikale dhe horizontale janë evidentuar shtresa të shumta kulturore duke filluar nga periudha e bronzit të vonë e deri në vitin 1912- 1913. Strukturat arkitekturore janë të ndërtuara me gurë të ndryshëm gëlqeror të terrenit, gur të dobët me ngjyrë gati në të zezë dhe gurë lumi të lidhur me llaç gëlqerorë. Gurët e punuar janë vendosur zakonisht neper qoshe, harqe, porta etj. dhe tullat e pjekura janë përdorur vetëm për nivelizim apo tek portat.

Kalaja ka një peizazh të veçantë kulturore.

Shtojcë 3: Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.

Funksioni (përdorimi) aktual /Shfrytëzuesi/t/Pronësia e ndërtimeve dhe tokës

Kalaja tani është monument kulture në shërbim të turizmit kulturor, ndërsa parcela është e regjistruar si pronë e Komunës së Prizrenit. Kalaja është nën menaxhimin e Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Instituti Arkeologjik i Kosovës - IAK).

Zhvillimi historik dhe kronologjik i asetit

- *Përshkrimi i formësimit të asetit nga themelimi deri në gjendjen aktuale, duke specifikuar ndryshimet, transformimet, demolimet apo rindërtimet domethënëse në historinë e konservimit.*
- *Ndërlidhur me asetet e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike, të bëhet paraqitja e fazave kryesore ndërtimore për: monumente, ansamble, fusha të konzervimit arkitektural, lokalitete dhe rezervate. Peizazhi kulturor, të përshkruhet sipas të dhënave të lartëshënuara, duke përfshirë aspektin e historisë dhe kronologjisë së aktiviteteve njerëzore në mjedisin natyror.*

Kalaja e Prizrenit nuk është krijuar - ndërtuar menjëherë si në formën e tanishme të saj. Mendojmë se fillimisht ka qenë një vendbanim i periudhës së bronzit dhe vetëm në antikitetin e vonë ka filluar ndërtimi i murit rrethues dhe disa mureve brenda kalasë. Ndërtime të shumta kanë ndodhur edhe gjatë periudhës mesjetare dhe osmane. Shkatërrimi i madh i saj ka ndodhur me luftërat ballkanike ku dëmtohet rënd kati i fundit i murit perëndimor, magazina , xhamia etj. Pas kësaj date filloj degradimi i madh nga faktori njeri dhe natyrë. Vetëm në vitet e 50 të shekullit të kaluar filluan të merren masa të vogla konservuese. Në vitin 1969 filluan gërmimet e para arkeologjike dhe u bënë disa konservime emergjente të mureve. Në vitin 2004 është bërë gërmim me karakter sondazh dhe për tu vazhduar nga viti 2009 deri më sot. Nga viti 2013 krahas gërmimeve me karakter pastrimi është bërë edhe konservim-restaurimi i shumë strukturave si dhe është duke u bërë adaptimi i tyre për turizëm kulturor (Shih planet e ndryshme).

3. PROPOZIM DEKLARATA E RËNDËSISË NË PËRPUTHJE ME ATRIBUTET DHE VLERAT

- *Atributet dhe vlerat që paraqet aseti, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 4, Rreg. Nr.05, 2008, MKRS.*
- *Analiza analoge e aseteve të njëjta në nivelin lokal, shtetëror dhe më gjerë.*
- *Autenticiteti/Integriteti*
-

Kalaja e Prizrenit është një ndër monumentet më të veçanta të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës. E vendosur në një gurë masiv shkëmbor, me pozitë të veçantë ajo paraqet një kurrorë të qytetit të Prizrenit. Rëndësinë këtij monumenti ia rritë edhe më shumë

depozitimet kulturore mjaft intensive që kapin një gamë kohore 3500 vjeçare dhe që mundëson studimin e shumë aspekteve kronologjike, kulturore , ekonomike etj.

Kalaja e Prizrenit është shumë e ngjashme me kalanë e Shkodrës, Krujës etj.

Aktualisht kalaja është shndërruar nga një fortifikatë e veçantë në një pikë të jashtëzakonshme të turizmit kulturor.

4. GJENDJA E ASETIT/ FAKTORËT NDIKUES DHE RREZIKU

- *Përshkrimi i gjendjes së ruajtjes të elementeve origjinale të asetit*
- *Përshkrimi i gjendjes teknike*
- *Faktorët ndikues ndaj asetit, presionet e zhvillimit bashkëkohor, adaptimet, transformimet, demolimet, ndërtimet e reja, agrokultura, veprimet ilegale, ndotja, fatkeqësitë natyrore, aksidentale, etj.*

Kalaja e Prizrenit aktualisht është në gjendje të mirë falë aktiviteteve konservuese që kanë ndodhur sidomos në 5 vitet e fundit. Në masë prej 75 % të sipërfaqeve janë trajtuar në aspektin konservues dhe shpresojmë që deri në vitin 2018 të përfundohet si projekt por edhe me komponentët e prezantimit, adaptimit dhe planit të menaxhimit (CHwB është duke i përfunduar komponentet e lartcekura)

5. DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS

- *Fotografi dhe material audiovizuel, në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Kopje e Formularit standard të regjistrimit të asetit në Inventarin e Trashëgimisë Kulturore (ID Kartela).*
- *Kopje e Aktit të mëhershëm mbi statusin ligjor të asetit.*
- ***Shtojcë 1***, A4-Harta e lokacionit të asetit në territorin e Komunës përkatëse, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- ***Shtojca 2***, Planet e situacionit të asetit me shenjëzim të kufirit perimetral dhe zonës rrethuese, $P=1:200$ dhe $P=1:500$, në formë të shtypur dhe dixhitale.
- *Plani kadastral i asetiit të propozuar për mbrojtje dhe zonës rreth tij, me paraqitjen e të dhënave për parcelat, shfrytëzuesit/pronarët dhe përdorimi i tokës.*
- *Harta topografike në shkallë të gjerë, me shenjëzim të kufirit perimetral të asetit dhe zonës rreth tij (buffer zone), në formë të shtypur dhe dixhitale.*
- *Informatat gjeografike dixhitale për kufirin e perimetrit të asetit dhe zonës rreth tij të paraqiten në formë vektoriale.*
- ***Shtojcë 3:*** Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale të ndërtesës/strukturës, ndërtesave/strukturave kryesore të asetit të propozuar për mbrojtje, në $P=1:200$, përfshirë planimetritë dhe prerjet kryesore, fasadat (pamjet) karakteristike, perspektivat, dhe fotografitë karakteristike të enterierit dhe eksterierit.




Foto e vitit 1862 e bere nga J.G.von Hane. Ne foto shihet qarte xhamia, shtëpi mbi murin perëndimor , sahat kulla , porta jug -perëndimore etj.




Foto e vitit 1889 e bere nga pjesa jugore e kalase - mbi kalasë. Kjo është fotoja me e mire e bere nga pjesa jugore, larte kalas. Ne foto shihet qarte qyteti jugor, Kulla me e madhe (11 X 11 m) pran murit lindore qe ka tri ose katër etazh, pastaj Magazina ose Mullini sipas skicës se vitit 1832, etazh- kati mbi murin perëndimor te qytetit te poshtëm, sahat kulla , muri shume mire i ruajtur pran tuneli- daljes se fshehte etj.



Fotot e vitit 2004 ku shifet gjendja e kalase e mbuluar me vëgjetacion te shumet dhe muret ne shume pjesë mezi vreheshin. Kazamatet poashtu ishin te muluar dhe mbushur me meturina.



Skicë e vitit 1830- 40



Planimetria e Kalasë së Prizrenit



Foto gjatë gërmimeve në vitin 1969



Disa artefakte te periudhave te ndryshme



Disa predha te ndryshme te topave in situ.

6. PËRGATITJA E FORMULARIT

Institucioni: [Instituti Arkeologjik I Kosovës](#)

Hartuesit i formularit: [Shafi Gashi](#)

Personi i autorizuar: [Enver Rexha](#)

Adresa dhe kontakti:

Data: .../.../.....

Nënshkrimi: